# Doncafe Albania Sh.p.k.

## Pasqyrat financiare

## per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

# Permbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2015 ... 1
Pasqyra e te ardhuarave permbledhese per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 ... 2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 ... 3
Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 ... 4
1. Informacion i pergjithshem ... 5
2. Baza e pergatitjes ... 5
3. Permbledhje e politikave kontabel ... 6
4. Percaktimi i vleres se drejte ... 9
5. Menaxhimi i riskut financiar ... 10
6. Aktive afatgjata materiale ... 11
7. Aktive afatgjata jo-materiale ... 11
8. Kerkesa te tjera per arketim ... 11
9. Mjete monetare dhe ekuivalente me to ... 11
10. Kapitali aksionar ... 12
11. Huamarrje afatgjata ... 12
13. Tatimi mbi fitimin ... 12
14. Instrumentat financiare ... 13
15. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara ... 15
16. Ngjarjet pas dates se raportimit ... 15

# Doncafe Albania Sh.p.k

## Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2015

*(Vlerat ne Leke)*

| | Shenime | 31 Dhjetor 2015 | 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| **Aktive** | | | |
| Aktive afatgjata jo-materiale | 7 | 664,270,221 | 664,270,221 |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | **664,270,221** | **664,270,221** |
| | | | |
| Kerkesa tregtare per arketim | 14 | 1,421,021 | 2,975,869 |
| Tatim fitimi i parapaguar | | 1,589,821 | 1,589,821 |
| Kerkesa te tjera per arketim | 8 | 3,532,573 | 3,532,573 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 9 | 26,939,375 | 26,911,757 |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | | **33,482,790** | **35,010,020** |
| **Totali i aktiveve** | | **697,753,011** | **699,280,241** |
| | | | |
| **Kapitalet e veta** | | | |
| Kapitali aksioner | 10 | 184,260,000 | 184,260,000 |
| Rezerva e rivleresimit | | (123,635,352) | (135,678,859) |
| Rezerva ligjore | 10 | 1,586,983 | 1,586,983 |
| Humbje te mbartura | | (262,518,763) | (257,870,546) |
| **Totali i kapitaleve te veta** | | **(200,307,132)** | **(207,702,421)** |
| | | | |
| **Detyrime** | | | |
| Huamarrje afatgjata | 11 | 894,423,298 | 906,466,804 |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **894,423,298** | **906,466,804** |
| | | | |
| Furnitore | | 251,314 | 294,337 |
| Detyrime ndaj paleve te lidhura | 15 | - | - |
| Detyrime te tjera | | 3,385,531 | 221,522 |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **3,636,845** | **515,858** |
| | | | |
| **Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta** | | **697,753,011** | **699,280,241** |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjese perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 17.

Keto pasqyra financiare u aprovuan nga Administratoret e Shoqerise me 30 Mars 2016 dhe u firmosen ne emer te tyre nga:

Andi Pacani
*Perfaqesues i autorizuar nga Shoqeria*

# Doncafe Albania Sh.p.k

## Pasqyra e te ardhuarave permbledhese per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

*(Vlerat ne Leke)*

| | Shenime | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| Shpenzime te pergjithshme dhe administrative | 12 | (4,020,340) | (1,078,558) |
| Amortizim / zhvleresim i aktiveve afatgjata materiale | 6 | - | - |
| Te ardhura / (shpenzime) te tjera | 7 | - | - |
| **Rezultati nga veprimtarite shfrytezuese** | | **(4,020,340)** | **(1,078,558)** |
| Te ardhura financiare | | 2,897 | 1,258,331 |
| Shpenzime financiare | | (630,774) | (182,320) |
| **Humbja para tatimit** | | **(4,648,217)** | **(2,547)** |
| Tatimi mbi fitimin | 13 | - | - |
| **Humbja neto per vitin** | | **(4,648,217)** | **(2,547)** |
| **Shpenzime te tjera permbledhese** | | | |
| Efekti i rivleresimit te huave afatgjata ne monedhe te huaj | | 12,043,498 | (6,321,570) |
| **Totali i shpenzimeve permbledhese per vitin** | | **7,395,281** | **(6,324,117)** |

Pasqyra e te ardhurave permbledhese duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjese perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 18.

# Doncafe Albania Sh.p.k

## Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

*(Vlerat ne Leke)*

| | Kapitali aksioner | Rezerva e rivleresimit | Rezerva ligjore | Humbje te mbartura | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2013** | **184,260,000** | **(129,357,289)** | **1,586,983** | **(257,867,989)** | **(201,378,295)** |
| **Totali i shpenzimeve permbledhese per vitin** | - | **(6,321,571)** | - | **(2,547)** | **(6,324,118)** |
| Humbja neto per vitin | - | - | - | (2,547) | (2,547) |
| Efekti i rivleresimit te huave afatgjata ne monedhe te huaj | - | (6,321,571) | - | - | (6,321,571) |
| **Kontribute nga pronaret dhe shperndarje pronareve** | - | - | - | - | - |
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2014** | **184,260,000** | **(135,678,860)** | **1,586,983** | **(257,870,536)** | **(207,702,413)** |
| **Totali i shpenzimeve permbledhese per vitin** | - | **12,043,498** | - | **(4,648,217)** | **7,395,281** |
| Humbja neto per vitin | - | - | - | (4,648,217) | (4,648,217) |
| Efekti i rivleresimit te huave afatgjata ne monedhe te huaj | - | 12,043,498 | - | - | 12,043,498 |
| **Kontribute nga pronaret dhe shperndarje pronareve** | - | - | - | - | - |
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2015** | **184,260,000** | **(123,635,362)** | **1,586,983** | **(262,518,753)** | **(200,307,132)** |

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjese perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 18.

# Doncafe Albania Sh.p.k

## Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

*(Vlerat ne Leke)*

| | Shenime | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| **Flukse monetare nga veprimtari shfrytezuese** | | | |
| Humbja neto e vitit | | (4,648,217) | (2,547) |
| (Humbja)/fitimi nga veprimtarite shfrytezuese para ndryshimeve ne kapitalin punues | | **(4,648,217)** | **(2,547)** |
| Pakesim i kerkesave per arketim | | 1,554,848 | 32,618 |
| Rritja e llogarive te pagueshme | | 3,120,954 | (1,672) |
| Tatim fitimi i paguar | | - | - |
| **Mjete monetare neto perdorur ne veprimtarite e shfrytezimit** | | **27,585** | **28,399** |
| **Flukse monetare nga veprimtarite investuese** | | | |
| **Mjete monetare nga/(perdorur ne) veprimtarite investuese** | | **-** | **-** |
| **Flukse monetare nga veprimtarite financuese** | | | |
| Financime nga/(pagesa per) huamarrjet | 11 | - | - |
| **Mjete monetare nga/(perdorur ne) veprimtarite financuese** | | **-** | **-** |
| **(Pakesimi)/rritja neto e mjeteve monetare** | | **27,585** | **28,399** |
| Mjete monetare ne fillim te vitit | | 26,911,790 | 26,883,391 |
| **Mjete monetare ne fund te vitit** | 9 | **26,939,375** | **26,911,790** |

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjese perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 18.

## 1. Informacion i pergjithshem

Doncafe Albania Sh.p.k ("Shoqeria") eshte filial i Strauss Coffee B.V, Rotterdam dhe rrjedhimisht filial i Strauss-Group Ltd ("Strauss-Group"), Israel.

Shoqeria u themelua me 30 Mars 2008 me vendim te bordit te drejtuesve ekzekutive te Strauss Coffee B.V. Shoqeria eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me 16 Prill 2008 si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e zoteruar plotesisht nga Strauss Coffee B.V.

Me 13 Maj 2008, Shoqeria hyri ne nje Marreveshje Bjerje Biznesi me Don Café Sh.p.k me qellim per blerjen e aktivitetit te prodhimit dhe tregtimit te kafese.

Gjate vitit 2010 Shoqeria shiti pajisjet dhe ndaloi prodhimin e kafese ne vend. Po ashtu gjate vitit 2011 pushoi dhe aktivitetin e shitjes se kafese. Aktualisht, aktiviteti i Shoqerise eshte i fokusuar ne mbledhjen e borxheve nga klientet e saj.

Gjate vitit 2015 Shoqeria nuk ka te punesuar (2014: 0). Administratori i Shoqerise eshte Zoti Sinisa Danicic, i cili nuk eshte resident ne Shqiperi, por deklarohet ne administraten tatimore si i punesuar vetem per qellime tatimore.

## 2. Baza e pergatitjes

### (a) Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare bashkangjitur jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten ne Leke, e cila eshte monedha funksionale per Shoqerine.

### (d) Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon qe drejtimi te kryeje gjykime, çmuarje dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhme qe ndikohen.

Ne veçanti, informacion mbi elemente te rendesishem ne vleresimin e pasigurive dhe gjykime kritike per aplikimin e politikave kontabel qe kane efekt material ne vlerat kontabel ne pasqyrat financiare jepet ne shenimi 7 - Aktive afatgjata jo-materiale.

## 3. Permbledhje e politikave kontabel

### (a) Aktive afatgjata materiale

*(i) Njohja dhe matja*

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi (shih politiken kontabel 3(c)).

Kosto perfshin shpenzime qe jane drejtperdrejt te ngarkueshme per blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve te ndertuara nga vete shoqeria perfshin koston e materialeve dhe te fuqise punetore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet drejtperdrejt me venien e aktivit ne vendin dhe kushtet e nevojshme qe ai te jete i perdorshem ne menyren e synuar nga drejtimi.

*(ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te ardhme qe i atribuohen atij elementi do t'i perkasin Shoqerise, dhe nese kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje ne menyre lineare gjate jetes se dobishme te aktiveve. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese nuk eshte e pakonsiderueshme) jane rivleresuar ne daten e raportimit.

Jeta e dobishme per çdo kategori aktivesh per periudhen aktuale dhe ate krahasuese eshte si me poshte:

| | |
|---|---|
| • Makineri dhe pajisje | 7-14 vjet |
| • Mobilje dhe pajisje zyre | 5-10 vjet |
| • Automjete | 6 vjet |
| • Makina ekspresi kafeje | 3 vjet |

### (b) Aktivet jo-materiale

*(i) Emri i mire*

Emri i mire perfaqeson vleren shtese qe rezulton nga diferenca midis kostos se blerjes dhe vleres se drejte te pjeses se aktiveve te identifikueshme neto ne aktivitetin qe ka blere Shoqeria ne daten e blerjes. Emri i mire qe rezulton nga blerja e aktiviteteve perfshihet ne "aktivet jo-materiale". Emri i mire testohet çdo vit per zhvleresime te mundshme dhe mbartet me kosto minus humbjet e akumuluara per zhvleresime. Humbjet nga zhvleresimi i emrit te mire nuk anullohen.

Emri i mire i bashkangjitet njesise gjeneruese te mjeteve monetare per qellime testimi per zhvleresim. Ai i bashkangjitet atyre njesive apo grupeve gjeneruese te mjeteve monetare te cilat pritet te perfitojne nga blerja e biznesit prej nga lindi fillimisht emri i mire.

## 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

### (c) Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqerise, perveç inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyra rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka evidenca per zhvleresim.

Aktivet te cilat kane nje jete te dobishme te pafundme, si per shembull emri i mire, nuk amortizohen dhe testohen per zhvleresime ne menyre vjetore. Shiko politiken kontabel 3(b). Aktivet te cilat amortizohen rishikohen per zhvleresime atehere kur ngjarje apo ndryshime rrethanash tregojne se vlera kontabel mund te mos rekuperohet. Humbja nga zhvleresimi njihet ne masen qe vlera kontabel e nje aktivi tejkalon vleren e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja ndermjet çmimit neto te shitjes dhe vleres se tij ne perdorim. Per qellimet e vleresimit te humbjes, aktivet grupohen ne njesi gjeneruese te mjeteve monetare, i cili eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse monetare qe jane te pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Aktivet jo-financiare perveç emrit te mire te cilat kane patur zhvleresime rishikohen per anullime te zhvleresimit ne çdo date raportimi.

### (d) Instrumentet financiare

Shoqeria mban vetem instrumente financiare jo-derivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, kredi dhe hua, dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejt me pervetesimin e tyre. Njohja ne vijim e instrumenteve financiare jo-derivative pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet ne rast se Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te Shoqerise ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar mbarojne, ose nese Shoqeria i transferon aktivin financiar nje pale tjeter, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktivi financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen Shoqeria zotohet te bleje ose te shese aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Shoqerise te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anulluar

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne arke, llogari rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere, dhe perdoren nga Shoqeria ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

*Kerkesa per arketim*

Kerkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara per humbjet per zhvleresime.

*Llogari te pagueshme*

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

*Huamarrjet*

Huamarrjet nga aksioneret njihen fillimisht me kosto. Huamarrjet e tjera njihen fillimisht me vlere te drejte. Huamarrjet mbarten ne vijim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Te tjera*

Instrumenta financiare te tjere jo-derivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

Kontabilizimi per te ardhurat dhe shpenzimet financiare eshte diskutuar ne politiken kontabel 3(h).

### 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (e) Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese nje evidence objektive tregon se nje ose me teper ngjarje qe kane ndodhur kane patur nje ndikim negativ ne flukset e çmuara te ardhshme te mjeteve monetare te aktivit financiar.

Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si diference ndermjet vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te mjeteve monetare, skontuar me normen fillestare te interesit efektiv te aktivit financiar.

Aktivet financiare te cilat jane te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vleresohet bashkarisht ne grupe qe mbartin karakteristika te ngjashme risku. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje. Nje humbje zhvleresimi mund te anullohet nese ulja ne zhvleresim ka ndodhur per shkak te nje ngjarjeje qe ka ndodhur pasi eshte njohur zhvleresimi. Anullimi njihet ne fitim ose humbje.

#### (f) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqerise njihet me vleren nominale.

#### (g) Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale njihen ne momentin kur ato ndodhin.

#### (h) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi prej llogarive ne banka dhe fitimet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit, komisionet bankare dhe humbjet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen ne fitim ose humbje duke perdorur metoden e interesit efektiv.

#### (i) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbja e vitit perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje perveç pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera permbledhese.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Ne percaktimin e shumes se tatimit aktual dhe te shtyre Shoqeria merr ne konsiderate impaktin me pozicione tatimore te pasigurta dhe nese tatime apo interesa shtese mund te paguhen. Shoqeria beson se perllogaritjet per detyrimet tatimore jane te pershtatshme per te gjithe vitet e hapura tatimore bazuar ne vleresimet e shume faktoreve qe perfshijne implementimin e legjislacionit tatimor dhe eksperiencat e meparshme. Informacione te reja mund te behen te vlefshme dhe shkak qe Shoqeria te ndryshoje gjykimin ne lidhje me pershtatshmerine e detyrimeve tatimore aktuale; te tilla ndryshime ne detyrime tatimore do te ndikojne ne shpenzimet tatimore ne periudhen qe ky percaktim eshte bere.

Tatimi i shtyre eshte llogaritur duke perdorur metoden e detyrimit ne bilanc, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit aktivi te mund te perdoret. Aktivi tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfitim fiskal.

### 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

### (j) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i kembimit per zerat monetare eshte diferenca ndermjet kostove te amortizuara ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kostove te amortizuara ne monedhe te huaj te konvertuara me kursin e kembimit ne fund te periudhes. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vlere te drejte konvertohen ne monedhe funksionale me kursin e kembimit ne daten kur eshte vendosur vlera e drejte. Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne fitim ose humbje, perveç diferencave nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi i huave nga aksioneret te cilat njihen ne te ardhurat permbledhese.

### (k) Standarte dhe interpretime te reja ende te pa-adoptuara

Nje numer standartesh te reja, ndryshime ne standarte dhe interpretime nuk jane ende efektive per fundin e vitit 31 Dhjetor 2015, dhe nuk jane aplikuar ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare. Perveç atyre te pershkruara me poshte, asnje prej tyre nuk do te kete ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

## 4. Percaktimi i vleres se drejte

Nje numer i caktuar politikash kontabël dhe shenimesh shpjeguese te Shoqerise kerkojne përcaktimin e vleres se drejte per aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejte eshte përcaktuar per matjet dhe/ose per qellime shpjeguese bazuar ne metodat e meposhteme. Kur aplikohen, informacionet e mëtejshme rreth supozimeve te bera ne përcaktimin e vleres se drejte jepen ne shenimet shpjeguese te aktivit ose detyrimit:

*Aktivet financiare te matura me koston e amortizuar*

Vlera e drejte e tregut dhe kërkesave te tjera te arketueshme vlerësohet me vleren aktuale te flukseve te ardhshme e skontuar me normen e interesit te tregut ne daten e raportimit. Vlera e drejte përcaktohet per qellime shpjeguese.

*Detyrimet financiare te matura me koston e amortizuar*

Vlera e drejte qe eshte përcaktuar per qellime shpjeguese, llogaritet duke u bazuar ne vleren aktuale te pricipalit dhe interesave te flukseve monetare te ardhshme te skontuara me normen e interesit te tregut ne daten e raportimit.

Vlera e drejte e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to, llogarive te arketueshme dhe te pagueshme eshte perafërsisht te barabarte me vleren kontabël per shkak te maturitetit te tyre afatshkurter.

Huaja e marre nga aksioneret e Shoqerise eshte pa interes dhe e pagueshme ne 5 vjet. Drejtuesit nuk jane perpjekur te vleresojne huane me vleren e drejte bazuar ne nje llogaritje te normes efektive te interesit.

## 5. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqeria eshte ekspozuar ndaj rreziqeve te meposhtme nga perdorimi i instrumenteve financiare:

-risku i kredise
-risku i likuiditetit
-risku i tregut

Ky shenim paraqet informacion rreth ekspozimit te Shoqerise ndaj secilit prej rreziqeve te mesiperm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqerise per matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shenime te mëtejshme sasiore jane perfshire ne keto pasqyra financiare.

Instrumentet financiare kryesore te Shoqerise konsistojne ne vlerat ne arke dhe ne banka, huamarrjet, llogarite e arketueshme dhe te pagueshme dhe detyrime te tjera afatshkurtra.

Politikat e drejtimit te riskut te Shoqerise jane krijuar per te identifikuar dhe analizuar riskun me te cilin perballet shoqëria, per te vendosur limite dhe kontrolle te përshtatshme, per te monitoruar riskun dhe zbatimin e limiteve.

Instrumentat kryesore financiare te Shoqerise konsistojnë ne mjetet monetare ne arke dhe ne banke, huamarrjet, llogarite tregtare te arketueshme dhe te pagueshme.

### *(i) Risku i kredise*

Risku i mos-pageses ekziston kur pala tjeter nuk mund te permbushe detyrimet per pagesen e llogarive te arketueshme.

Maksimumi i riskut te kredise per instrumentet financiare jo-derivative eshte teorikisht i barabarte me vleren e drejte te te gjitha llogarive te arketueshme minus detyrimet kundrejt te njejtit debitor kur kompensimi eshte i lejuar. Risku i kredise i cili eshte identifikuar merret parasysh nepermjet zhvleresimeve. Shoqeria e vlereson cilesine e llogarive te arketueshme qe nuk jane me vonese dhe as te zhvleresuara si te kenaqshme.

### *(ii) Risku i likuiditetit*

Shoqeria duhet te permbushe nevojat per mjete monetare, kryesisht per kostot e shfrytezimit qe rrjedhin nga aktivitetet e saj. Ekziston rreziku qe mjetet monetare mund te mos jene te disponueshme per te shlyer detyrimet ne kohen e duhur me nje kosto te arsyeshme. Shoqeria monitoron likuiditetin ne baza periodike ne menyre qe te menaxhoje detyrimet e saj kur ato kerkohen.

### *(iii) Risku i tregut*

*Risku i normave te interesit*

Shoqeria nuk disponon instrumente financiare me interes me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014. Huamarrjet me palet e lidhura jane pa interes.

*Risku i kursit te kembimit*

Shoqeria ndermerr transaksione ne Leke, Euro dhe USD. Risku i pozicionit valutor menaxhohet nepermjet parimit te perputhjes se aktiveve me detyrimet. Megjithate, Shoqeria ka nje detyrim financiar neto te percaktuar ne Euro, i cili mund te rezultoje ne levizje valute te pa-perputhura kur perkthehet ne Leke. Shoqeria nuk ka hyre ne ndonje marreveshje derivative per kontrata te ardhshme shkembimi me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014.

*Analiza e ndjeshmerise*

Me anen e menaxhimit te riskut te normave te interesit dhe te pozicionit valutor, Shoqeria synon te reduktoje ndikimin e luhatjeve afatshkurtra ne fitimet e Shoqerise.

### *(iv) Menaxhimi i kapitalit*

Shoqeria nuk eshte subjekt i kerkesave te kapitalit te vendosura nga ente rregullatore. Shoqeria mbeshtetet nga aksioneri i vetem Strauss Coffee B.V.

## 6. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale ne 31 dhjetor 2015 perbeheshin si me poshte:

| | Makineri dhe pajisje | Mobilje dhe orendi | Automjete | Makineri kafeje | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kosto** | | | | | |
| **Me 1 Janar 2015** | **5,338,324** | **197,469** | **13,393,933** | **33,871,993** | **52,801,719** |
| Transferime nga inventaret | - | - | - | - | - |
| **Me 31 Dhjetor 2015** | **5,338,324** | **197,469** | **13,393,933** | **33,871,993** | **52,801,719** |
| **Amortizimi i akumuluar dhe humbjet nga zhvleresimi** | | | | | |
| **Me 1 Janar 2015** | **(5,338,324)** | **(197,469)** | **(13,393,933)** | **(33,871,993)** | **(52,801,719)** |
| Amortizimi per vitin | - | - | - | - | - |
| Zhvleresimi per vitin | - | - | | - | - |
| **Me 31 Dhjetor 2015** | **(5,338,324)** | **(197,469)** | **(13,393,933)** | **(33,871,993)** | **(52,801,719)** |
| **Vlera kontabel** | | | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2015** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** |

Drejtimi i Shoqerise ka vendosur qe aktivet materiale te mbetura jane zhvleresuar plotesisht me 31 Dhjetor 2015.

## 7. Aktive afatgjata jo-materiale

Me 13 Maj 2008, Shoqeria u be pjese e nje Marrveshje Blerje Biznesi me Don Café Sh.p.k. me qellimin e blerjes se biznesit te prodhimit dhe tregtimit te kafese. Emri i mire i njohur si rezultat i blerjes ishte 664,270,221 Leke.

## 8. Kerkesa te tjera per arketim

Kerkesat e tjera per arketim perfshijne sa me poshte:

| | 31 Dhjetor 2015 | 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| TVSH e rimbursueshme | 1,968,148 | 1,968,148 |
| Te tjera | 1,564,425 | 1,564,425 |
| **Totali** | **3,532,573** | **3,532,573** |

## 9. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente perbehen si me poshte:

| | 31 Dhjetor 2015 | 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Llogari rrjedhese | | |
| Ne Leke | - | - |
| Ne USD | 17,755,782 | - |
| Ne Euro | 9,183,593 | - |
| Depozita me afat | | |
| Ne Leke | - | 18,500,000 |
| Ne USD | - | 8,411,790 |
| Ne Euro | - | - |
| **Total** | **26,939,375** | **26,911,790** |

## 10. Kapitali aksionar

Me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 kapitali themeltar eshte 184,260,000 Leke i ndare ne 184,260 aksione te zakonshme me vlere nominale 1,000 Leke secili. Rezervat ligjore jane ne shumen 1,586,983 Leke.

## 11. Huamarrje afatgjata

Huamarrjet afatgjata perfshijne huate nga aksioneri. Me 13 Maj 2008, aksioneri i vetem dhe Shoqeria hyne ne nje marreveshje huaje sipas se ciles aksioneri i vetem i akordoi Shoqerise nje hua me vlere deri ne ekuivalenten e 7,000 mije Euro-ve me norme interesi 0%. Koha per ripagimin e huase ishte 5 vjet nga data e disbursimit. Me 31 Dhjetor 2015 Shoqeria kishte 500,000 USD e perkthyer ne 62,895,000 Leke (2014: 500,000 USD e perkthyer ne 57,615,000 Leke) dhe 6,057,170 Euro e perkthyer ne 831,528,928 Leke (2014: 6,057,170 Euro e perkthyer ne 848,851,804 Leke) si hua pa interes nga aksioneri i saj.

Drejtuesit nuk jane perpjekur te masin vleren e drejte te huase bazuar ne vleresimin e normes efektive te interesit.

## 12. Shpenzime prodhimi dhe te tjera

Shpenzimet e kryera jane shperndare sipas kategorive dhe funksioneve si me poshte

| | 31 Dhjetor 2015 | 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Kontribute per sigurimet shoqerore | 423,986 | 422,953 |
| Keshillim teknik, kontabel, audit dhe ligjor | 607,452 | 558,820 |
| Taksa vendore | 47,120 | 47,121 |
| Gjoba dhe penalitete | 3,164,695 | - |
| **Total** | **4,020,340** | **1,078,558** |

## 13. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi te ardhurat ne Shqiperi vleresohet me normen 15% per vitin 2015 dhe 2014 mbi te ardhurat e tatueshme. Me poshte paraqitet rakordimi i tatimit mbi te ardhurat te llogaritur me normen e aplikueshme tatimore, me shpenzimin tatimor mbi te ardhurat:

| | |
|---|---|
| **Humbja kontabel e vitit** | **(4,648,217)** |
| Shpenzimet e pazbritshme | 3,164,695 |
| ***Humbja e tatueshme e vitit 2015*** | ***(1,483,522)*** |
| | |
| ***Tatim fitimi (15%)*** | **-** |
| Tatimi i shtyre | - |
| | |
| **Humbja neto 2015** | **(4,648,217)** |

## 14. Instrumentat financiare

### Ekspozimi ndaj rrezikut te kredise

Vlera kontabel e aktiveve financiare perfaqeson ekspozimin maksimal ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi maksimal ne daten e raportimit ishte:

| | 31 Dhjetor 2015 | 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Kerkesa tregtare per arketim | 1,421,021 | 2,975,869 |
| Kerkesa te tjera per arketim | 3,532,573 | 3,532,573 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 26,939,375 | 26,911,790 |
| | **31,892,969** | **33,420,232** |

### Humbje nga zhvleresimi

Analiza sipas vjetersise e kerkesave per arketim ne daten e raportimit eshte:

| | 31 Dhjetor 2015 | 31 Dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Me shume se 90 dite ne vonese | 133,279,736 | 134,834,584 |
| **Vlera bruto** | **133,279,736** | **134,834,584** |
| | | |
| Provizion per zhvleresim | (131,858,715) | (131,858,715) |
| **Gjendje ne fund te vitit** | **1,421,021** | **2,975,869** |

### Ekspozimi ndaj rrezikut te likuiditetit

Me poshte paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit te mbetur me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014:

| | 31 Dhjetor 2015 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Deri ne 6 muaj** | **6 deri ne 12 muaj** | **1 deri ne 5 vjet** | **Mbi 5 vjet** | **Totali** |
| Kerkesa tregtare per arketim | 1,421,021 | - | - | - | 1,421,021 |
| Kerkesa te tjera per arketim | 3,532,573 | - | - | - | 3,532,573 |
| Tatim fitimi i parapaguar | - | - | - | - | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 26,939,375 | - | - | - | 26,939,375 |
| | **31,892,969** | | | | **31,892,969** |
| | | | | | |
| Hua afatgjata | | - | 894,423,298 | - | 894,423,298 |
| Detyrim ndaj paleve te lidhura | - | - | - | - | - |
| Furnitore | 251,314 | - | - | - | 251,314 |
| Detyrime te tjera | 221,522 | - | - | - | 221,522 |
| | **472,836** | **-** | **894,423,298** | **-** | **894,896,134** |
| **Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2015** | **31,420,134** | **-** | **(894,423,298)** | **-** | **(863,003,164)** |

14. Instrumentat financiare (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut te likuiditetit (vazhdim)

| | 31 Dhjetor 2014 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Deri ne 6 muaj** | **6 deri ne 12 muaj** | **1 deri ne 5 vjet** | **Mbi 5 vjet** | **Totali** |
| Kerkesa tregtare per arketim | 2,975,869 | - | - | - | 2,975,869 |
| Kerkesa te tjera per arketim | 3,532,573 | - | - | - | 3,532,573 |
| Tatim fitimi i parapaguar | - | - | - | - | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 26,911,757 | - | - | - | 26,911,757 |
| | 33,420,199 | | | | 33,420,199 |
| Hua afatgjata | - | - | 906,466,804 | - | 906,466,804 |
| Detyrim ndaj paleve te lidhura | - | - | - | - | - |
| Furnitore | 294,336 | - | - | - | 294,336 |
| Detyrime te tjera | 221,522 | - | - | - | 221,522 |
| | **515,857** | **-** | **906,466,804** | **-** | **906,982,662** |
| **Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2014** | **32,904,324** | **-** | **(906,466,804)** | **-** | **(873,562,463)** |

**Ekspozimi ndaj rrezikut valutor**

Ekspozimi i Shoqerise ndaj rrezikut valutor ne 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 eshte si me poshte:

| | 31 Dhjetor 2015 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **EUR** | **USD** | **LEKE** | **Total** |
| Kerkesa tregtare per arketim | 1,421,021 | - | - | 1,421,021 |
| Kerkesa te tjera per arketim | - | - | 3,532,573 | 3,532,573 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | - | 9,183,593 | 17,755,782 | 26,939,375 |
| | **1,421,021** | **9,183,593** | **21,288,355** | **31,892,969** |
| Hua afatgjata | 831,528,298 | 62,895,000 | - | 894,423,298 |
| Furnitore | - | - | 251,314 | 251,314 |
| Detyrime te tjera | - | - | 221,522 | 221,522 |
| | **831,528,298** | **62,895,000** | **472,836** | **894,896,133** |
| **Rreziku valutor me 31 Dhjetor 2015** | **(830,107,277)** | **(53,711,407)** | **20,815,519** | **(863,003,164)** |

## 14. Instrumentat financiare (vazhdim)

| | 31 Dhjetor 2014 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **EUR** | **USD** | **LEKE** | **Total** |
| Kerkesa tregtare per arketim | 2,975,869 | - | - | 2,975,869 |
| Kerkesa te tjera per arketim | - | - | 3,532,573 | 3,532,573 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | - | 8,411,790 | 18,500,000 | 26,911,790 |
| | **2,975,869** | **8,411,790** | **22,032,573** | **33,420,232** |
| Hua afatgjata | 848,851,804 | 57,615,000 | - | 906,466,804 |
| Furnitore | - | - | 294,336 | 294,336 |
| Detyrime te tjera | - | - | 221,547 | 221,547 |
| | **848,851,804** | **57,615,000** | **515,883** | **906,982,687** |
| **Rreziku valutor me 31 Dhjetor 2014** | **(845,875,935)** | **(49,203,210)** | **21,516,690** | **(873,562,455)** |

Kurset e kembimit ne fund te periudhes raportuese jane si meposhte:

| | **31 Dhjetor 2014** | **31 Dhjetor 2014** |
|---|---|---|
| 1 USD | 125.79 | 115.23 |
| 1 EUR | 137.28 | 140.14 |

## 15. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Shoqeria nuk ka angazhime dhe detyrime te kushtezuara me 31 Dhjetor 2015.

## 16. Ngjarjet pas dates se raportimit

Drejtimi i Shoqerise nuk eshte ne dijeni te ndonje ngjarjeje tjeter pas dates se raportimit e cila mund te kerkoje rregullime ose shenime shpjeguese shtese ne pasqyrat financiare.